



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.2, datë 28.01.2021

PËR
MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFTIUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE ME FONDE
NGA TË ARDHURAT E BASHKISË DURRËS PËR MUAJIN JANAR 2021

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës 87 familje me një fond 291.920 lekë.
2. Të hiqen nga skema e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për këtë muaj gjithsej 5 (pesë) familje.
3. Në muajin Janar 2021, hiqen nga skema e ndihmës ekonomike 5 (pesë) familje nga fondi i Bashkisë, për arsytet e mëposhtme:

- A. Njësia Administrative Nr. 1**
- Gjonovefa Pupi Përfituese tek skema e ndihmës ekonomike.
 - Agron Peqini Përfituese tek skema e ndihmës ekonomike.
- B. Njësia Administrative Nr. 3**
- Esmeralda Nezha Ndryshim në certifikatë.
- C. Njësia Administrative Nr. 4**
- Fatmira Kërtusha Punësuar.
 - Sokol Fejzo Nuk është paraqitur.

4. Në muajin Janar 2021, futen në skemën e ndihmës ekonomike 2 (dy) familje, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës.

- A. Njësia Administrative Nr. 1**
- Denada Dura Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3960 lekë.
- B. Njësia Administrative Nr. 5**
- Xhemile Baroti Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë.

5. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia, 0 familje.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.01.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 89/prot.

2

Durrës, më 29.01.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 2 datë 28.01.2021 “Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike me fonde nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për muajin Janar 2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

